



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**  
**VENDIM**

Nr. 30, datë 26 / 02 /2026

**“PËR**  
**MIRATIMIN E STEMËS (LOGON) TË INSTITUCIONIT QENDRA E SHËRBIMEVE**  
**PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËS DHE FAMILJES KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.7, shkronja c, nenit 54, shkronja “k” dhe “l”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr. 168 dt 29.09.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror” me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e stemës/ logos të Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Stema/logoja e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, do të përdoret në të gjithë dokumentet administrative të prodhuara nga ky institucioni.
3. Ngarkohet Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, për zbatimin e këtij vendimi.
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 26-02-2026

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**ANA VERUSHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KORÇA  
QYTETI EVROPIAN  
I SPORTIT 2020

BASHKIA KORÇË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TE BURIMEVE  
NJERËZORE

NR. \_\_\_\_ PROT.

DATË \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

## RELACION

“PËR  
MIRATIMIN E STEMËS (LOGON) TË INSTITUCIONIT QENDRA E SHËRBIMEVE  
PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËS DHE FAMILJES KORÇË”

Në kuadër të procesit të deinstitucionalizimit dhe transformimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për fëmijë 0-5 vjeç, janë ndërmarrë dhe konsoliduar hapa të rëndësishëm dhe konkretisht është miratuara Metodologjia e Transformimit për shërbimet rezidenciale për fëmijët 0-5 vjeç në vitin 2024 duke shkuar më tej drejt shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen.

Në vijim të këtij procesi është miratuar Urdhëri i Kryeministrit nr. 168 dt 29.09.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror”, duke reflektuar ndryshimin e tipologjisë së shërbimit dhe orientimin e ri funksional.

Rezulton se institucioni Shtëpia e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë ka ndryshuar emërtimin duke u quajtur Shërbimi Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen.

Në kushtet e ndryshimit të emërtimit por dhe organizimit dhe funksionimit të institucionit, lind nevoja e miratimit të një steme/ logoje të re që të identifikojë institucionin e ri të krijuar “Shërbimi Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen”. Referuar urdhërit të Kryeministrit nr 168 dt 29.09.2025 organika e qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Korçë është: 1 drejtor, sektor i Shërbimit Social 9 punonjës (1 Përgjegjës sektori dhe 8 kujdestarë) dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve të Brendshme 4 punonjës (1 përgjegjës sektori, 1 kuzhinier dhe 2 pastrues).

Sa më lart parashtruam, në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.7, shkronja c, nenit 54, shkronja "I", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr. 168 dt 29.09.2025 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror", i propozojmë Këshillit të japë miratimin për përdorimin e stemës/ logos të Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes" sipas modelit bashkëlidhur, në të gjitha shkresat zyrtare dhe dokumentat administrative të prodhuara nga ky institucion.

Drejtoreshë e Përgjithshme:

A. Qeramixhi (Dishnica)



Drejtoreshë e Qendrës së Shërbimeve

për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Korçë

Klementina Gjecka



KRYETAR I BASHKISË

Sotirajq Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË  
P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

“PËR  
MIRATIMIN E STEMËS (LOGON) TË INSTITUCIONIT QENDRA E SHËRBIMEVE  
PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËS DHE FAMILJES KORÇË”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.7, shkonja c, nenit 54, shkronja “k” dhe “l”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr. 168 dt 29.09.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror” me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e stemës/ logos të Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Stema/logoja e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, do të përdoret në të gjithë dokumentet administrative të prodhuara nga ky institucioni.
3. Ngarkohet Qendra e Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes, për zbatimin e këtij vendimi.
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me \_\_\_\_\_vota  
Vota Pro \_\_\_\_\_  
Vota Kundër \_\_\_\_\_  
Vota Abstenim \_\_\_\_\_  
Zbardhur më datë \_\_\_\_\_

